



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 22.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **18.05.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Matkos Pharm Sh.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Preparate Stomatologjike për DSHB" me Nr. të Prok: **206-23-2009-1-2-1 nxjerr**:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **Matkos Pharm Sh.P.K** e dt. 18.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Preparate Stomatologjike për DSHB" me Nr. të Prok: **206-23-2009-121** kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 15.05.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i publikuar me datë 15.05.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **Matkos Pharm Sh.P.K** me date 18.05.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Preparate Stomatologjike për DSHB" me Nr. të Prok: **206-23-2009-121**. Autoriteti Kontraktues, me datë 22.05.2023, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe sot me datën 22.05.2023, vendosi si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkëlur nga Autoriteti Kontraktues sipas **Matkos Pharm Sh.P.K: Interpretimi i KRPP-se i dates 22.11.2022**

Pretendimi ankimor

8. 22.11.2022 Në rast se OE përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit me Vendim të OSHP-së, përjashtimi a vlen nga data e Vendimit të OSHP-së apo përjashtimi vlen edhe për aktivitetet e prokurimit që janë në proces të iniciuara para datës së vendimit të OSHP-së?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron OPINIONIN si në vijim:

Paragrafi 2 i nenit 99 të LPP-së, përcakton:

"2 Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare".

Paragrafi 2 i nenit 99 të LPP-së përcakton një masë sanksionuese ndaj operatorëve ekonomik sipas të cilës me një vendim të formës së prerë iu ndalohej operatorëve ekonomik të marrin pjesë në aktivitetet e prokurimit deri në një (1) vit.

Dispozita e lart cituar nuk përcakton se kjo ndalesë vlen për aktivitetet e prokurimit që publikohen pas datës së vendimit të formës së prerë, apo edhe për aktivitetet e prokurimit që janë në proces.

Megjithatë,

OPINIONI i KRPP-së është si në vijim:

Operatori Ekonomik në çdo rast përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit prej momentit kur ka ndodhë deklarata e rreme. Pra, prej momentit kur konstatohet rrethana e sanksionuar dhe meqenëse dispozita e lart cekur nuk përcakton asgjë, përjashtimi duhet të vlejë për aktivitetet e prokurimit të publikuara brenda periudhës së përcaktuar me këtë nen.

Përjashtimi nuk duhet të vlejë për aktivitetet e prokurimit që janë në proces (të publikuara para datës së vendimit për përjashtim), për dy arsye:

E para: sanksioni duhet të vlejë vetëm për aktivitetet e prokurimit të publikuara brenda një viti nga data e vendimit, përndryshe sanksioni do të kthehej në fakt para kohës kur ka ndodhë rrethana e sanksionuar; dhe

E dyta: Nëse përjashtimi do të zbatohet edhe për aktivitetet e prokurimit që janë në proces, efekti i tij i vërtetë sanksionues do të ishte për një periudhë më shumë se një vit, gjë që do të binte ndesh me ligjin.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimor

Ne lidhje me dispozitën e shkelur për te cilat pretendon "Matkos Pharm Sh.P.K", Autoriteti Kontraktues hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

MSh ne rastin konkret ka vepruar ne përputhje me Nenin 32, paragrafin 2 te Rregullores se Punës se OSHP-se i cili Nen përcakton:

Neni 32

Diskualifikimi i operatoreve ekonomike

1. OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik. Kur OSHP me kërkesë nga një autoritet kontraktues, inicicion një shqyrtim lidhur me informata të rremë ose dokumente të falsifikuara, siç përmendet në nenin 99 (2) të LPP-së, ajo duhet t'i sigurojë operatorit ekonomik të drejtën për t'u dëgjuar duke përfshirë edhe garancitë ligjore të përmendura në nenin 107 të LPP-se.

2. Nëse diskualifikimi aprovohet sipas kërkesës së autoritetit kontraktues, atëherë operatori ekonomik i diskualifikuar nuk mund të marr pjesë në asnjë aktivitet të prokurimit që përfshin aktivitetet e prokurimit aktuale dhe të ardhshme. Diskualifikimi është i vlefshëm nga momenti i nxjerrës së vendimit lidhur me diskualifikimin, deri në periudhën kohore të përcaktuar në vendim të panelit shqyrtues. Për qëllime të kësaj dispozite aktiviteti i prokurimit ndër të tjerash përfshin dhe nënshkrimin e kontratës publike me autoritetin kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit